



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 nëntor 2017
Nr. ref.: RK1149/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI29/16

Parashtrues

Afërdita Gashi-Sinanaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 236/2015, të 5 tetorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Afërdita Gashi-Sinanaj, nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 236/2015, të 5 tetorit 2015, të cilin parashtruesja e ka pranuar më 18 nëntor 2015.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesja kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, për të cilin pretendon se i ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën e pronës [nenet 31 përkatësisht 46 të Kushtetutës].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 shkurt 2016, parashtruesja nëpërmjet postës paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 14 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës, me vendim, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 11 tetor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.
8. Më 30 maj 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 17 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin C. nr. 610/2010, me të cilin aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit SH. H. dhe vërtetoi se atij i takon e drejta e shfrytëzimit të pronës-truallit në Prishtinë, duke u bazuar në kontratën mbi shitblerjen VR. nr. 2712/2000, të 10 tetorit 2000 të lidhur në mes tij si blerës dhe avokatit H. S. i cili me autorizim kishte përfaqësuar SH. A. (tani të ndjerë) pronar i paluejtshmërisë.
10. Me aktgjykimin si më sipër në pikën III, Gjykata kishte vërtetuar se është nul kontrata mbi shitblerjen e lidhur dhe e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, më 25 prill 2001 në mes të bashkëshortes së pronarit SH. A., tani të ndjerë, në cilësinë e shitëses, e cila pretendonte se është pronare e po të njëjtit truall në bazë të trashëgimisë sipas Aktvendimit T. nr. 69/2001, të 23 marsit 2001, dhe këtu parashtrueses së kërkesës në cilësinë e blerëses.

11. Më 9 dhjetor 2013, parashtruesja e kërkesës dhe SH. A. paraqitën ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për shkak të: a) të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe b) të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
12. Më 3 mars 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin AC. nr. 3055/12, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
13. Më 24 prill 2015, parashtruesja e kërkesës parashtrroi në Gjykatën Supreme të Kosovës kërkesë për revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
14. Më 5 tetor 2015, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 236/2015, e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtrueses për revizion.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesja e kërkesës ka pretenduar se ajo nuk ka pasur fare dijëni të jetë iniciuar një padi civile kundër saj, nuk ka marrë pjesë fare në gjykimin e shkallës së parë, ndërsa më tej ka potencuar se Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme kanë dështuar ta vlerësojnë drejtë faktin kyç të këtij procesi që është veprimi juridik i të autorizuarit (avokatit), që të lidhë kontratë për shitblerje në emër të autorizuesit gati një vit pasi dhënësi i autorizimit (pronari i truallit për të cilin është zhvilluar kontesti) kishte vdekur.
16. Parashtruesja më tej pretendon se ajo në mënyrë tërësisht të ligjshme është bërë pronare e paluejtshmërisë së kontestuar, dhe të njëjtën pa asnjë pengesë e kishte regjistruar në librat kadastral dhe e kishte marrë në posedim. Sipas saj, vendimet gjyqësore qartazi kanë shkelur nenin 31 dhe 46 të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtrueses, Gjykata paraprkishtë vlerëson nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe të specifikuara më tej me Rregulloren e punës së Gjykatës.
18. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”
19. Më tej, Gjykata merr në konsideratë nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese rreth saktësisht të kërkesës, i cili përcakton se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

20. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, ku përcaktohet:
- (1) *“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
(...)*
- (d) *kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
- (b) *faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.”*
21. Lidhur me si më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesja ka paraqitur një kërkesë individuale, pasi i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe në afatin e paraparë me nenin 49 të Ligjit, andaj, Gjykata do të shqyrtojë meritat e rastit në raport me pretendimet e ngritura për shkelje kushtetuese.
22. Gjykata rikujton se neni 53 i Kushtetutës e obligon Gjykatën Kushtetuese që *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”* andaj, gjatë shqyrtimit të rastit kjo praktikë do të merret në konsideratë.
23. Në dritën e pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata konstaton se parashtruesja ka kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 236/2015, të 5 tetorit 2015, i cili ishte vendim përfundimtar duke theksuar se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe e drejta e pronës të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, të cilat në pjesën relevante për rastin kanë këtë përmbajtje.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

[.....]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. *E drejta e pronës është e garantuar.*

2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*

3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprihimin e pronës nëse ky eksproprihim është i autorizuar me ligj,*

është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.

[.....]

24. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih në mes tjerash *mutatis mutandis Edwards kundër Mbretërisë së bashkuar*, 16 dhjetor 1992., f. 34, seria A nr. 247 dhe B . *Vidal kundër Belgjikës*, 22 prill 1992. f. 33, seria A nr. 235)
25. Edhe pse në aktgjykimet e gjykatave të rregullta Gjykata ka vërejtur ca gabime të përsëritura, si psh. data e vërtetimit të kontratës mbi shitblerje e lidhur në mes të parashtrueses dhe SH.A., diku përcaktohet si 25 prill 2014, e diku si 25 janar 2014; ose në vendimet gjyqësore të instancave të ndryshme ngatërrohen emrat e palëve në procedurë psh. në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme emrat e dhënësit të autorizimit ndryshojnë, megjithatë Gjykata thekson se në parim nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit të kryera nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla të mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë. (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, [DHM], Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28). Në këtë drejtim, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit.
26. Lidhur me si më sipër, Gjykata vëren se parashtruesja ka pretenduar se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme lidhur me revizionin, por edhe aktgjykimet tjera të gjykatave të rregullta, nuk kanë respektuar garancitë e nenit 31 të Kushtetutës, për shkak të mos njoftimit të saj për procesin gjyqësor të iniciuar kundër saj dhe rrjedhimisht, mospjesëmarrjes së saj në gjykimin e shkallës së parë e gjithashtu edhe për shkak të mos arsyetimit të mjaftueshëm të vendimeve gjyqësore për faktet kyçe, sepse gjykatat e rregullta nuk kanë arritur të shpjegojnë qartë elementin kyç të procesit të vërtetimit të një kontrate për shitblerje në Gjykatën komunale në Prishtinë nga një avokat me autorizim i cili përdori autorizimin gati një vit pas vdekjes së autorizim-dhënësit.
27. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se Gjykata Komunale në Prishtinë në Aktgjykimin e vet C. nr. 610/2010 në pjesën arsyetuese kishte theksuar: “*I ndjeri Sh.A. i ka dhënë autorizimin avokatit H. S. nga Prishtina, për shitjen e paluajtshmërisë kontestuese, i cili autorizim është regjistruar nën numrin 5/99 datë 10.02.1999, në Gjykatën Komunale në Prishtinë ku pas kësaj i ndjeri Sh.A. ka vdekur me 14.12.1999, në Prishtinë. Pas vdekjes të Sh.A., paditësi lidhë kontratë mbi shitblerjen e puluajtshmërisë kontestuese dhe përfaqësuesit të Sh.A. e cila kontratë është vërtetuar në gjykatë nën numrin VR.nr. 2712/2000 datë 10.02.2000*”.
28. Gjykata Komunale më tej ka arsyetuar: “*E paditura (bashkëshortja e të ndjerit SH.A.) pas vdekjes së Sh.A. e shqyrton trashëgiminë dhe në bazë të aktvendimit T. nr. 69/2001, datë 23.03.2001, shpallet për trashëgimtare dhe këtë*

paluajtshmëri ia shet Afërdita Gashit nga Prishtina me kontratën Vr.nr.2172/2001, datë 15.01.2001 dhe i dorëzon në posedim dhe shfrytëzim këtë paluajtshmëri.”

29. Lidhur me çështjen e vlefshmërisë së autorizimit dhe përdorimit të tij nga ana e avokatit pas vdekjes së autorizim-dhënësit, gjykata kishte arsyetuar: *“Pasi i ndjeri Sh.A. ka vdekur me datë 14.12.1999, ndërsa në bazë të autorizimit të dhënë me datë 10.02.1999 paditësi ka vërtetuar nënshkrimet në kontratë në Gjykatën Komunale në Prishtinë me VR.nr. 2712/2000 me datë 10.02.2000, pra kur ka qenë i vdekur Sh. A., e në kuptim të dispozitës së nenit 94 par.3 të LMD-së ky autorizim vlen në rastet kur puna e filluar nuk mund të ndërpritet pa i shkaktuar dëme pasuesve juridik apo duke marrë parasysh karakterin e punës dhe vullnetin e prokurdhënësit.”*
30. Gjykata e Apelit, duke refuzuar ankesën e parashtrueses me Aktgjykimin AC. nr. 3055/12, kishte pranuar tërësisht vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ndër të tjera, në aktgjykim kishte theksuar: *“Në këtë gjendje të çështjes juridiko-civile kjo gjykatë ka vlerësuar përfundimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se i njëjti është i drejtë dhe i bazuar, se ka mbështetje në provat e zhvilluara dhe në shkresat e lëndës dhe se janë dhënë arsye të justifikueshme të cilat edhe kjo gjykatë i pranon.”*
31. Kjo gjykatë më tej arsyetoi: *“Po ashtu, kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe se gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë sikundër që e ka zbatuar drejt edhe të drejtën materiale”.*
32. Gjykata më tej vëren se Gjykata Supreme duke vendosur sipas kërkesës së parashtrueses për revizion ka përcaktuar: *“Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët, në bazë të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, se aktgjykimin i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë nuk përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykate i vëren sipas detyrës zyrtare, se gjykatat e instancës më të ulët në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme, për faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.”*
33. Gjykata gjen se edhe Gjykata Supreme në aktgjykimin lidhur me revizionin iu ka referuar çështjes së autorizimit në mënyrë specifike të kontestuar nga parashtruesja duke konstatuar se: *“tani i ndjeri Sh.A. ka autorizuar avokatin Halim Sylejmani, nga Prishtina, që t'i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale, për vërtetimin pranë gjykatës të kontratës mbi shitblerjen dhe paditësit t'ia bartë të gjitha të drejtat pronësore, i cili autorizim është vërtetuar në gjykatë me Vr.nr.5199 date 10.2.1999, ku pastaj me 14.12.1999 vdes Shaip Hamidi, si autorizim dhënës.”*
34. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se Gjykata Supreme me aktgjykimin e kontestuar ka vendosur ta refuzojë kërkesën për revizion, duke mbështetur konstatimin e gjendjes faktike dhe ligjin e zbatuar nga gjykatat e instancave më

të ulëta dhe gjithashtu gjerësisht ka elaboruar pretendimet e parashtrueses lidhur me të gjitha çështjet e ngritura, duke dhënë përgjigje lidhur me autorizimin e kontestuar sikur edhe validitetin e kontratave të lidhura për shitblerjen e paluejtshmërisë që ishte objekt i kontestit.

35. Gjykata gjithashtu konstaton se edhe pretendimi për mospjesëmarrje në seancën gjyqësore si bazë tjetër të ngritur për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë e të paanshëm, Gjykata Komunale në Prishtinë i kishte dhënë përgjigje, duke konstatuar se parashtruesja ishte ftuar në mënyrë të rregullt në seancë gjyqësore, dhe ajo nuk kishte arsyetuar në asnjë mënyrë mungesën e saj “*andaj gjykata në kuptim të nenit 423.4 të LPK-së seancën kryesore e mbajti në mungesën e saj.*”
36. Në këto rrethana të rastit, kur çështjet kyçe të ngritura nga parashtruesja janë trajtuar gjerësisht nga gjykatat e rregullta, kur tri instanca gjyqësore kanë dhënë vlerësimin juridik dhe zgjidhjen ligjore për kontestin në mes të palëve Gjykata nuk mund të gjejë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
37. Meqenëse shkelja e nenit 46 [Mbrojtja e pronës] supozohej të jetë shkelur si pasojë e gjykimit jo të drejtë e të paanshëm, Gjykata rrjedhimisht nuk gjen as shkelje të nenit 46 të Kushtetutës.
38. Gjykata, bazuar në parimin e subsidiaritetit, nuk ka rolin e gjykatës së shkallës së katërt dhe nuk gjykon lidhur me rezultatin përfundimtar të vendimeve gjyqësore (Shih, rasti *Fc Metrebi v Georgia* par. 31 Aktgjykimi i GJENDJ-së, i 31 korrikut 2007), e që gjykuar sipas rrethanave të rastit duket se qëllimi i parashtrueses ka qenë pikërisht kontestimi i rezultatit të procesit gjyqësor.
39. Bazuar në atë që u përmend më lart, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesja në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës së pronës, andaj në përputhje me rregullin 36 paragrafi (2), pika (b) dhe (d) gjen se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 (2) (b), (d) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 maj 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi